



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Empowered lives.
Resilient nations.

*Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor
financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga
Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).*

DURRËSI DHE TRASHËGIMIA E TIJ



*"Erdha në Durrës
sepse është një
qytet i lirë..."*



Ciceroni



SHOQATA

*Udhëtim i lirë
LIBERI DI VIAGGIARE*

Shoqata "Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare"

Nën kujdesin e Dr. Lorenc Agalliu

*Përgatiti: Aurela Frroku, Ejona Limanaj, Elda Marku,
Erdis Çelshima, Enxhi Lipa, Genta Mësaja, Gred Braho,
Orin Agalliu, Marvina Mansaku, Xhejda Tusha*

Përkthimi: Jovan Likja

Jeta social - kulturore në Durrës Të dhëna demografike

Përpara se të flasim për jetën social-kulturore të Durrësit mendoj se është e rëndësishme të dimë pak më shumë për popullsinë dhe zhvillimin demografik të tij ndër vite. Qarku i Durrësit (ku përfshihen rrethet Durrës dhe Krujë) ka regjistruar në popullsi prej 290.126 banorësh ose 10.1% të numrit gjithsej të republikës, duke zënë vendin e tretë pas qarkut të Tiranës me 31,3 % të popullsisë gjithsej dhe qarkut të Fierit me 10,3 % të popullsisë gjithsej. Raporti gjinor i popullsisë qëndron në diferenca të vogla, ku regjistrohen 146.760 meshkuj dhe 143.366 femra. Bashkia Durrës përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manza.

Historiku i Qytetit

Durrësi mund të krahasohet me qytetet më të mëdhenj të Mesdheut antik dhe mesjetar. Qyteti Epidamn - Dyrrah u ndërtua nga Ilirët Taulantë, në shekujt XIII-XI p K. Në bregdetin e Gjirit të Durrësit u vendos qendra e parë apo limani me emrin Dyrrah. Sipas autorëve antikë, ky qytet u themelua nga dy mbretër me origjinë ilire të quajtur Dyrrah dhe Epidamn. Në kohën e Perandorit Anastasi I (491-519) dhe Justianani I [527-565), qyteti pësoi transformime të ndjeshme në strukturën urbane duke marrë tiparet e një qyteti tipik bizantino-kristian.

Në shek. XI-XV, Shteti Shqiptar njihet me emrin Shteti i Arbrit, i cili kulmin e arriti në periudhën e mbretërimit të Gjergj Kastriotit. Sipas kronikaneve osmanë të shek. XVI, Durrësi u pushtua nga turqit me 13 Gusht 1501. Vetëm në shek XVII, qyteti filloi të rimarrë veten duke u bërë qendër e tregtisë tranzite dhe skela kryesore e Shqipërisë së Mesme. Më 26 Nëntor 1912 në Durrës ngrihet flamuri i Pavarësisë. Sundimit turk i kishte ardhur fundi, por duket se qytetin e lakmonin invazione të tjera: pushtimi serb (1913), ai austro-hungarez (1916) dhe pushtimi italian (1918).

Gjatë viteve të monarkisë shqiptare (1928-1939), Durrësi fitoi një frymëmarrje të re dhe qytetaria fisnike durrsake e bëri qytetin e vet model të zhvillimit ekonomik.

Më 7 Prill 1939 qyteti dhe rrethinat e tij u pushtuan nga trupat e ushtrisë italiane. Më 14 Nëntor 1944, Durrësi u çlirua prej forcave naziste. Periudhës së sistemit socialist (1945-1990) i përkasin investimet në disa degë të industrisë, kolektivizimi i bujqësisë, masivizimi i arsimit, ngritja e objekteve social-kulturore. Në fillim të viteve '90 zunë fill normat e para të sistemit demokratik me shumë probleme për fazën e tranzicionit, por me perspektivë për të ardhmen. Sistemi i ri dhe reformat ekonomike që u zbatuan në Shqipëri dhe në Durrës pas vitit 1990, sollën transformime të ndjeshme në jetën ekonomike. Ndryshime sociale për qytetin e Durrësit solli eksodi i vitit 1990 dhe 1991 ku mijëra njerëz morën rrugën e emigrimit drejt Italisë dhe vendeve të tjera evropiane.



Durrësi ndër vite ka tërhequr vëmendjen e turistëve të huaj. Shumë prej tyre e kanë zgjedhur prej historisë që mbart, disa të tjerë për bregdetin e kthjellët e jo pak kanë bërë check-in në restorantet dhe hotelet që shërbejnë sipas traditave vendase të ndërthurura mjaft mirë me ato evropiane. Këto janë disa nga arsyet e para që e lartësojnë qytetin tonë në sytë e turistëve dhe travel blogger më të suksesshëm të momentit.

Duam apo jo ta pranojmë, rrjetet sociale ndikojnë në përzgjedhjen e destinacionit të pushimeve tona. Shpesh herë fotot e realizuara nga miqtë tanë në këto vende na ndjellin dhe magjepsin, madje na bëjnë edhe ziliqar që nuk jemi aty. Një rast i tillë është edhe hashtagu më i ri për Durrësin **#choosedurrës**.

Por çfarë duhet të dini përpara se ta ndërmmerni këtë sfidë kaq argëtuese?

Si fillim, Durrësi është një qytet i cili ka diçka për t'ju treguar në çdo kohë, që nga historitë me gladiatorë, bregdeti ranor, arkitektura, ushqimi e deri tek muzika në orët e vona, ndaj bëhuni gati për të papritura. Rrugicat e qytetit kanë gjithmonë një histori siç do qytet i lashtë. I vendosur mbi skelën natyrore detare, Dyrrahu e mori emrin nga gadishulli i vogël mbi të cilin ishte ndërtuar. Ndaj le të nisim rrugëtimin duke krijuar hashtagët e rinj për qytetin e vjetër.

Nuk mund ta fillojmë udhërrëfimin tonë në qytetin e Durrësit pa e nisur nga perla e antikitetit: Amfiteatri i tij.

#AmfiteatriiDurrësit mbetet një prej amfiteatrove më të mëdhenj të Ballkanit. I zbuluar relativisht vonë, në vitin 1966, nga arkeologu Vangjel Toçi në mënyrë paksa rastësore. Në oborrin e shtëpisë së një familje durrsake pema e fikut kishte rënë në një gropë disa metra e thellë. Vangjel Toçi, insistoi që toka të gërmohej. Këmbëngulja e tij u shpërblye, pasi aty ndodhej Amfiteatri i Durrësit i cili kërkohet prej vitesh, por nuk gjendej. Për zbulimin e amfitearit u desh largimi i familjeve durrsake që banonin mbi rrënojat e vjetra antike.

I ndërtuar gjatë shek. II të erës sonë, gjatë periudhës së sundimit të perandorit romak Trajan (98-117), Amfiteatri mbetet një prej ndërtesave më të mëdha romake në rajon si edhe një prej mrekullive të kohës.

Një pjesë e Amfiteatrit të Durrësit mbetet ende e pazbuluar, duke i shtuar këtij vendi misterin e një vepre jo të plotë. Pavarësisht kësaj mungese, funksionet e tij ndër shekuj mbeten mëse të qarta edhe në ditët tona. Në shkallët e amfiteatrit mendohet se shijonin spektaklin rreth 15 000 deri 20 000 spektatorë. I ndërtuar nga mjeshtërit vendas, me arenën, shkallaret, galeritë dhe dy menianume (ballkone apo llozha) në atë kohë amfiteatri vlerësohej si kolos i arkitekturës së lashtë. I përbërë prej gurësh dhe tullash, amfiteatri vishet nga një fasadë dy katëshe, me harqe e kolonadha të dekoruara me dritare të cilat shohin drejt qendrës së qytetit. Kalimi poshtë tuneleve në brendësi të amfiteatrit do t'ju kujtojë skenën e hyrjes së Maximus në arenën e Koloseut mes brohoritjeve të spektatorëve në filmin "Gladiator", me gjithë ndjesitë që ajo skenë përcjell. Nëse e gjen veten në perëndim të amfiteatrit, do të gjendesh pak hapa larg bregut të Adriatikut. Deri këtu, besoj se keni kuptuar se vizita premtion shumë përjetime të lavdishme si edhe mundësia për të bërë foto kujtimi që ju shoqërojnë në jetën tuaj.

Si në rastin e Koloseut, lojërat po aq argëtuese sa edhe vdekjeprurëse, shënuan pikën më kulminante të Amfiteatrit. Pasi ato u ndaluan prej perandorit Honor (393-423 e.s), arena e hershme e gladiatorëve në Amfiteatër u shndërrua në varrezë.

Në shekujt e mëvonshëm (V-VI), në Amfiteatër u ndërtua edhe një kishë (kapelë) ku realizoheshin ceremonitë fetare dhe funerale të banorëve të qytetit.

Fillimisht, muret e kësaj kapele ishin të zbukuruara me afreske të cilat më pas u kthyen në panele mozaikësh të martirit të qytetit të Durrësit, Shën Stefanit, si edhe të plot shenjtëve të tjerë si Shën Mëria, Shën Irena, Shën Sofia, dhe Shën Gabrieli. Pra, me sa duket, amfiteatri pati fatin të kalonte prej fazës së argëtimit në atë të pendimit. Në anën lindore, kapela ka absidën me një afresk të dëmtuar dhe altarin. Në pjesën perëndimore ruhen të vetmet mozaikë muralë në Shqipëri.

Majtas është paraqitur Shën Stefani si martir i parë i kishës. Në të majtë të tij, është paraqitur Shën Mëria si mbretëreshë e qiejve. E paraqitur me veshje mbretërore, ajo prezantohet me kurorën mbretërore, skeptrin dhe globin në të dy duart e saj. Atë e shoqërojnë në të dy krahët arkangjejtë Mihal dhe Gabriel.

Në panelin qendror, por mjaft të dëmtuar, paraqiten katër figura madhështore, dy prej të cilave indentifikohen si Sofia (dituria) dhe Irini (paqja). Në këmbët e dy figurave të mesit janë paraqitur dy figura të tjera të vogla njerëzore. Në të është i dallueshëm mbishkrimi bizantin "**O Zot mbro skllavin tënd Aleksandër**", që mendohet se i dedikohet dhuruesit të kishës.

Mbas vizitës në Amfiteatrin e Durrësit dhe pushimit në një nga kafenetë që ndodhen pranë tij, marrim rrugën e tregtarëve, ku përballemi me Xhaminë e Madhe.

Ndërtimi i këtij objekti kulti i besimit islam filloi në vitin 1931. Në vitin 1967, regjimi komunist vendosi prishjen e institucioneve fetare në Shqipëri. Xhamia i shpëtoi shkatërrimit të plotë, por ajo u kthye në institucion kulturor për argëtimin e rinisë durrsake. Vetëm pas ndryshimeve demokratike në vitin 1991, Xhamia u kthye sërish në institucion fetar, ku besimtarët myslimanë kryejnë ritet për adhurimin e Zotit.

Pasi keni mbaruar udhëtimin ndër shekuj, mund të shëtisni në rrugët e qytetit të vjetër të Durrësit, dhe në perëndim të diellit, të uleni në një prej shumë restoranteve e lokaleve buzë detit.

Një eksperience e veçantë, po aq e re sa edhe e vjetër, e mirëpret entuziastin e historisë, artit, arkitekturës...po ashtu edhe të detit dhe frutave të tij, në qendër të qytetit të Durrësit.

Banjot termale (romake)

#Banjotromake (termet) u zbuluan gjatë ndërtimit të Pallatit të Kulturës në vitet 60 të shek.XX. Në afërsi të banjave romake u zbulua dhe mozaiku më i famshëm durrsak që u pagëzua me emrin "Bukuroshja e Durrësit". Mozaiku datohet rreth fundit të shek.IV dhe fillimi shek.III p.krishtit.

Ai sot gjendet i ekspozuar në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë.

Në këto terma dallohen mjaft qartë tre dhoma të mëdha të cilat shërbenin për popullsinë e asaj periudhe si sauna. Dhoma e parë e quajtur ndryshe "caldarium", ishte dhoma me ujë të ngrohtë, dyshemeja e të cilës ka qenë e shtruar me pllaka bardh e zi, njëlloj si dyshemeja e pishinës. Dhoma e dytë ishte "tepidariumi", dhoma me ujë të vakët dhe e fundit ishte "frigidariumi" që kuptohet edhe nga vetë emri, dhoma me ujë të ftohtë.

Falë një projekti bashkëpunimi mes arkeologëve shqiptarë dhe atyre francezë janë nxjerrë në dritë shtresa të reja helenistike të cilat shtrihen nën zbulimet arkeologjike romake të paeksploruara më parë. Puna 1-vjeçare e arkeologëve të projektit "Topografia e Epidam-Dyrrahut" u shpërblye pasi ata zbuluan rrënoja edhe më të hershme aty ku më parë ishin gërmuar banjat publike romake. Ky është rezultat i një bashkëpunimi mes Institutit Arkeologjik të Shqipërisë dhe Universitetit Lion të Francës. Qeramikat tregojnë se zbulimet e tyre datojnë në shek.III p.e.s, pra katër shekuj përpara banjave romake që njihen prej gërmi-meve të viteve 1960 në këtë zonë.Punët më të fundit kanë nxjerrë në dritë një shtëpi helenistike me dy dhoma në njërin prej të cilës ekzistonte një mozaik tashmë i shkatërruar.

Arkitektura e përdorur ka qenë mjaft e zgjuar dhe zbulimet lënë të kuptohet se qyteti ka qenë i pastër. Mendohet se ka qenë pikërisht periudha romake ajo që i ka dhënë Dyrrahut të vjetër kapërcimin gjigant drejt një jete më të mirë. Me rindërtimin dhe zgjerimin e qytetit u rikonstruktua dhe rrjeti i kanalizimeve të nëndheshme, të mbul-uara me harqe tullash, të cilat dëshmojnë se qyteti vazhdoi të ruante sistemin ortogonal të trashëguar nga antikiteti. Gjatë periudhës bizantine, Durrësi ishte një nga metropolet më të rëndësishme të Perandorisë Bizantine. Durrësi u bë një nga qendrat më të rëndësishme kishtarë peshkopale, duke pasur një histori të pasur kishtarë. Kjo dëshmohet nga ekzistenca e kishës së madhe të zbuluar në kodrat e Arapa-jt. Përmasat e kishës me një gjatësi prej 66 m dhe gjerësi

38 m tregon mjaft qartë rëndësinë e Durrësit si një nga qendrat peshkopale më të rëndësishme të kohës.

Durrësi është një qytet i cili ka fatin që është banuar përgjatë gjithë historisë së tij dhe kjo e bën atë të favorshëm për kërkimet arkeologjike që janë gjithnjë duke evoluar. Megjithatë sipas arkeologëve qyteti modern nuk të lejon shumë mundësi që të bësh kërkime masive, ndaj ata janë të detyruar të punojnë në zona të vogla. Kjo do të thotë se Durrësi ka akoma shumë thesare të pazbuluara nën sipërfaqe.

Forumi Bizantin

#ForumiBizantin (rotonda) është monument historik i cili gjendet pranë Pallatit të Kulturës në Durrës. I zbuluar në vitet 80, ky forum është një ndër monumentet më të vjetëra në qytetin e Durrësit i cili daton rreth shekujve V-VI, periudhës së Perandorit Anastas. I ndërtuar sipas stilit bizantin, ku në qendër ka shkallë në formë rrethi, dyshe-menë e veshur me pllaka mermeri dhe rrethuar nga kolona të të njëjtit material, ky monument ngjall kureshtjen e shumë vizitorëve.

Monumenti ka diametër 72 m. Nga paraqitja luksoze, ky monument duket se ka qenë një treg i argjendarëve të qytetit, i cili mbyllej gjatë natës me portën e vetme që të çonte në oborr. Disa studjues e kanë krahasuar edhe me forumin rrethor në Kostandinopojë, i cili tashmë nuk ekziston më, ndërsa në krenar e kemi ruajtur këtë shesh të lavdishëm i cili ishte jeta e qytetit, pasi në të kryheshin shkëmbimet tregtare, burimi kryesor i të ardhurave. Sot është vendi idela për të bërë disa shkrepje magjepsëse për profilin ose blogun tuaj, kështu do të ngjallin kureshtje dhe “zili” tek miqt tuaj virtual.

Pasi kemi vizituar keto vende që i perkasin antikitetit kthehemi dhe vizitojmë Muzetë e qytetit.

Në Durrës gjeni 3 muze të rëndësishëm: Muzeu Arkeologjik, Muzeu Etnografik, Muzeumi i Dëshmorëve.



*Pamje nga kalaja, Durrës
1914*



*Fusha e Lirisë, Durrës
1942*

Muzeu Arkeologjik

#MuzeuArkeologjik është muzeu arkeologjik më i madh i këtij lloji në Shqipëri. Muzeu është i organizuar në 3 pavione që përkojnë edhe me periudhat historike për të cilat janë gjetur gjurmë të zhvillimit të qytetërimit në Durrës, e që mishërohen me 3204 objekte. Sapo të hyni në muze do të përballeni me disa statuja që gjatë kalimin nga një shekull në tjetrin kanë humbur pjesë të tyre, por jo madhështinë. Eksplorimin e tij e nis me sallën e parë që fillon me vitrinën e gjetjeve prehistorike në qytet e rrethinat e tij. Në rend kronologjik ndiqet pandërprerje historia e qytetit në periudhën arkaike, klasike dhe qytetare ilire deri në shek. I pas krishtit. Në vazhdim shpaloset zhvillimi topografik, ekonomik, politik e kulturor i Dyrrachiumit romak. Në aspektin tematik ky qytet dëshmon praninë e një popullsie autoktone ilire me botë të pasur shpirtërore. Durrësi paraqitet qendër me ekonomi shumëdegëshe dhe që tregtonte me shumë qendra mesdhetare. Objektet e ekspozuara përfshijnë shekujt që nga antikitetit e deri në shek. XV me periudhën turke.

Muzeu Etnografik

#MuzeuEtnografik është edhe një shtëpi karakteristike durrsake e shek. XIX. Nga disa njihet edhe si Shtëpia Muze e Aleksandër Moisiut, aktor shqiptar që famën e mori përmes interpretimit të rolit të Hamletit në skenat e Vjenës. Në këtë shtëpi aktori kaloi vitet e para të jetës, periudhë të cilës i kushtoi edhe një skicë me titull "ëndërr fëmijërie". Një pjesë tjetër e njeh edhe si zyrat e konsullatës angleze e shek. XX. Gjithë këto emërtime për të njëjtën godinë, e cila që nga viti 1983 priti në ambientet e saj edhe "Ekspozitën e Kulturës Popullore", një vlerë e shtuar e qytetit të Durrësit.

Ekspozita gjendet në katin e dytë të kësaj ndërtese dhe përfaqësohet me disa dhoma. Materialet e ekspozuara janë autentike dhe të punuara nga mjeshtrit vendas. Ato ç'ka bien më shumë në sy në këtë ndërtesë janë: tavani detajet e të cilit janë ruajtur me fanatizëm punimet zbukuruese floreale dhe gjeometrike.

Por cilat janë dhomat që mund të vizitoni në këtë muze?

#DhomaeAleksandërMoisiut e cila ka gjithë detajet dhe faktet që kanë arritur për Moisiun në ditët e sotme. Gjithçka nis me pemën gjenealogjike të Moisiut dhe rrjedh më pas me letërkëmbimet që ai ka pasur me miqtë dhe familjarët e tij. Arsyeja e vendosjes së këtyre elementeve është për të treguar origjinën e tij shqiptare nga ana e babait, pasi vetë Aleksandër Moisiu lindi në Trieste dhe vetëm 5 vitet e para të jetës i kaloi në këtë dhomë.

#DhomaDedikuarA.Moisiut e cila ka një mori veprash të cilat i janë kushtuar aktorit të skenave botërore. Të gjitha pikturat ose skulpturat shoqërohen me tabela në të cilat përshkruhet jeta artistike e Moisiut, nga ku spikasin veprat e Kristaq Ramës, Qazim Kërtushës, Sabri Tuçi, Nexhmedin Zajmi, Spiro Mazhe, etj.

#DhomaeArtizanatit e cila përfshin një sërë punimesh të bëra gjatë periudhës së komunizmit me material të tillë si: alabastra (lloj gipsi), druri, bakri dhe brir kafshësh. Nuk mungojnë edhe punimet e dorës të punuar me aq mjeshtri nga gratë durrsake, njëra prej tyre është e qëndisur në mëndafsh me fije nga bishti i kalit. Vëmendje tërheq edhe jastëku i qëndisur me luspa peshku dhe fije ari. Detaji i fundit i cili të bën përshtypje janë qilimat dhe rrugicat që janë shtruar në dysheme që janë punuar në tezgjah.

#DhomaEtnografike e cila është e mbushur me veshje popullore të Shqipërisë së Mesme, të cilat kanë një sere veçorishë që do të përmenden më poshtë.

Veshjet e ekspozuara janë punuar nga vajzat e zonës dhe nëse përlllogaritet vlera e tyre mund të themi se janë goxha të kushtueshme. Kjo duket edhe tek elementet që ato kanë, p.sh veshja e grave përbëhej nga: këmbët e dimiqve, dimiqt, këmisha, jeleku, sako (xhybja), cervia (përparësja), shamia e kokës, bokshia, etj. Veshja tradicionale vishej në raste festash dhe jo rrallë edhe në përditshmëri. Veshja e burrave ishte më e thjeshtë pasi përbëhet nga: brekushtet, këmbët e brekusheve, këmisha, jeleku dhe qeleshja.

Mauzoleumi i Dëshmorëve

#MauzoleumiDëshmorëve i është dedikuar të rënëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në të gjenden eshtrat e dëshmorëve që dhanë jetën për çlirimin e atdheut dhe të rënëve në kampet naziste. Godina është projektuar nga arkitekti durrsak Kristo Sotiri dhe filloi të ndërtohej në vitin 1947.

I vetmi i këtij lloji, ai ngrihet solemn në formë gjysëm rrethi dhe i përbërë nga tre pjesë: Mauzoleu në të cilin gjenden edhe varret e dëshmorëve, shkallarja e cila finalizohet me një mozaik festiv dhe lulishtja e cila ofron një ndjesi paqe për turistët dhe vizitorët. Në ambientet e muzeleumit gjendet edhe një statujë si përkujtimore e cila nga të dyja anët e saj ka pllaka me emra të të vvarëve në kampin nazist në Porto Romano.

Pasi keni vizituar disa nga atraksionet kryesore të Durrësit do të shihni një sërë monumentesh që shpesh guidat i anashkalojnë ose nuk i japin rëndësinë e duhur. Ato gjenden në disa zona të fshehura nga syri i turistit dhe njihen kryesisht nga banorët vendas të cilët ia çmojnë vlerën dhe rëndësinë që kanë ato për qytetin.



*Banka Tregtare
parë nga porti Durrësit
1941*

Banka e Shtetit Shqiptar

#BankaeShtetitShqiptar në Durrës (sot BKT) u ndërtua në vitin 1928. Themelet e saj janë mbi kullën juglindore të rrethojës bizantine, e quajtur "Bastioni i madh". Ndërtesa është projektuar nga arkitektë italianë dhe realizuar nga mjeshtri durrsakë. Ajo është banka më e vjetër në Shqipëri e cila për nga ana kompozicionale hyn në veprat e stilit barok, që përdoret për herë të parë në vendin tonë. Mbi bankë është vendosur një skulpturë e mbretëreshës Teutë, e cila paraqet në mënyrë simbolike luftën, rezistencën dhe fitoren ndër shekuj dhe begatinë e vendit. Figura e Teutës na shfaqet me mjaft dritë-hije në histori, nga një anë shfaq largpamësi duke i dhënë rëndësi forcimit të flotës si element kyç i zhvillimit të qytetit dhe nga ana tjetër shihet qartë pakujdesia duke shpallur armiq gjithë fqinjët e saj bregdetar, një hap mjaft i pamatur nga pikëpamja e marrëdhënieve diplomatike. Pavarësisht gjithë luhatjeve gjatë sundimit 3 vjeçar mund të themi që ka qenë strategjia e parë femër e cila e meriton të qëndroj krenare mbi Bankën e Parë Shqiptare.

Kulla Veneciane

#KullaVeneciane është një nga veprat e tjera që na ka lënë pas Perandori bizantin Anastas I. Sinonim i saj është edhe kulla rrethore, që rrjedh nga forma e saj. Kulla u rikonstruktua gjatë periudhës që Durrësi ishte nën ndikimin venecian në shek. XV, fakt që vërtetohet nga prania e blloqeve që gjenden në të. Ndërtimi i saj është tepër i veçantë për shkak se porta e saj është në formën e një harku, shkallët që të çojnë në tarracë janë të brendshme dhe shumë të pjerrta, mbyllja e perimetrit të sipërm me bedena, 5 frëngjit e saj dhe ndarja me 3 kthina, të gjitha këto tregojnë për një arkitekturë mjaft të rafinuar, ku diametri është 16 m ndërsa lartësia 9 m përmasa të përshtatshme për të kryer funksionin parësor të saj, mbrojtjen e qytetit.

Konaku

#Konaku (Pallatimbretëror)

Vetëm pak metra larg kullës veneciane ndodhen rrënojat e një ndërtese, që edhe vetë durrsakët pak njohuri kanë për të. Sot mbi këto rrënoja është ndërtuar Veliera. Në këtë vend ka qenë i ndërtuar Pallati qeveritar i mytesarifit osman. Ndërtimi i Konakut sipas të dhënave mendohet të ketë filluar rreth vitit 1839 dhe të ketë mbaruar disa vite më vonë. Më 26 nëntor 1912 në këtë godinë është ngritur flamuri i Pavarësisë së Shqipërisë. Me mbrritjen e Princ Vidit në Shqipëri më 7 mars 1914, Durrësi u bë kryeqendra e Shqipërisë. Kjo ndërtesë shërbeu për rreth 6 muaj si pallati mbretëror i Vidit. Në tetor të vitit 1918, kjo ndërtesë bombardohet nga italianët dhe shkatërohet tërësisht. Tërmeti i vitit 1926 dhe projektet e arkitektëve italianë për ndërtimin e qytetit të ri mbuluan për rreth një shekull rrënojat e kësaj ndërtese.



Çisterna Mesjetare

#ÇisternaMesjetare është një depo uji e periudhës së mesjetës e cila ndodhet pas Muzeleumit të Dëshmorëve. Është një ndërtesë e cila për ajrosje ka një dritare rrethore ndërsa për hyrje ka 5 palë shkallë, detaje që tregojnë për një planifikim dhe strukturim mjaft të mirë.

Hamami Mesjetar

#HamamiMesjetar, ose ndryshe banjat e periudhës turke janë një monument kulture dhe vlerë për qytetin. Ndërtimi i tij është i përbërë nga mjedisi i zhveshjes i cili ka edhe një kupolë sferike që është rikonstruktuar para 30 vitesh. Lartësia e tij arrin deri në 6 metra dhe ajroset përmes 12 dritareve katrore, ndërsa në kulmin e kupolës ndodhet një gjysmë rrethi tjetër i cili ka tre dritare rrumbullake dhe ofron ndriçimin e mugar për këto mjedise. Ajo ç'ka e dallon këtë hamam është fakti se dyshemeja e tij ngrohej përmes tubacioneve të avullit të cilat dilnin nga furra, sistem i ndërlikuar për shekullin e XVIII. Gjëndjen e tij të tanishme mund të vini dhe ta shihni nga afër pasi ndodhet pranë bulevardit.

Rruga Tregtare

#RrugatTregtare është ndërtuar pas tërmetit të fuqishëm të vitit 1926 dhe është fillimi i modernizimit të urbanistikës së qytetit, përshtatja sipas ndërtimeve bashkëkohore europiane. Planin urbanistik të kësaj zone e ka ideuar Brasini, një nga arkitektët më në zë të kohës. Anët e saj ishin të veshura me vila 2-3 katëshe katet e para të cilave shërbenin si dyqane për tregtimin e mallarave të ndryshëm, nga ky detaj ajo mori edhe emrin "Rruga tregtare". Kohët e fundit ajo është parë nga një këndvështrim ndryshe, nga lart, dhe shumicës së personave i është dukur në formën e një spirance, një simbol i qytetit bregdetar të Durrësit. Kjo mbetet akoma një hipotezë e cila ka gjasa të vërtetohet dhe ti rris madhësinë kësaj rruge.

Historia e qytetit përmes busteve dhe skulpturave

Për dashamirësit e arteve vizive qyteti mund të shihet edhe në një këndvështrim tjetër atë të busteve, memorialeve, skulpturave. Fatëmirësisht Durrësi të ofron një larmi figurash të cilat janë formësuar në buste.

Bustet

Fan Noli

Lindi në vitin 1982 dhe vdiq në vitin 1965. Busti i Fan Nolit ndodhet në hyrje të kishës ortodokse, pranë ndërtesës së Bankës Kombëtare Tregtare. Prania e bustit të Fan Nolit pranë kishës ortodokse lidhet me faktin se Noli ka qenë krijuesi dhe kreu i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, e cila u njoh si e tillë nga Patriarkana e Stambollit në v.1937. Përveç të tjerash, Noli ka qenë politikan, shkrimtar, studiues dhe një patriot i madh i mbrojtjes së çështjes shqiptare në periudhat më të errëta të historisë së Shqipërisë. Noli ka qenë zëri i të drejtës kombëtare të popullit shqiptar në arenën ndërkombëtare.

Dom Nikoll Kaçori

Lindi në vitin 1862 dhe vdiq në vitin 1917. Dom Nikollë Kaçori ishte politikan dhe atdhetar shqiptar, klerik i njohur dhe nënshkruar Deklaratën e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 Nëntor 1912 dhe zëvendës Kryeministër i parë i Shqipërisë në kabinetin e Ismail Qemalit. Lindi në krahinën e Lurës, por pas përfundimit të shkollës teologjike u emërua ipeshkv në Durrës. Për veprimtarinë e frytshme kishtarë, Vatikani e nderoi me titujt "Kryqin e artë", "Për Kishë dhe Papë". Kaçori ishte ndër të parët në organizimin e shoqërive patriotike "Vllaznia" dhe "Bashkimi" në Durrës (1907 -1909). Më 28 nëntor 1912 ishte përfaqësues i Durrësit në shpalljen e Pavarësisë në Vlorë dhe prej kuvendit u zgjodh nënkryetar i qeverisë së parë shqiptare. Fjalët e Kaçorit në mbledhjen e Kuvendit të Vlorës ishin "Në qoftë për nesër, vdesim sot, o flamur o vdekje!"

Telat Noga

Busti i tij ndodhet pranë ish fabrikës së Duhanit, e cila para viteve '90 ka mbajtur emrin e tij. Telat Noga ishte një i ri antifashist dhe vdiq në kampin nazist të Manthauzenit në vitin 1945.

Azem Hajdari

Busti i tij ndodhet në qendër të qytetit të Durrësit. Azem Hajdari është shpallur "Dëshmor i Atdheut". Ai ishte deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe u vra në një pritë në vitin 1998. Hajdari ka qenë një nga studentët e lëvizjes demokratike të viteve 90 që synonin rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri.

Skulptura Rodonit

Zot i deteve edhe zoti fatsjellës i durrsakve është vendosur së fundmi në fillim të shëtitorës buzëdetit. Ajo është punuar nga mjeshtri Ilirjan Xhixha me materiale të veçanta të cilat përveç vlerave artistike përcjellin edhe mesazhin sensibilizues për riciklim. Nga kjo skulpturë mund të kuptoni edhe rrënjët e lashta që ka qyteti, i cili emrin e hyjnisë së deteve ia ka vendosur edhe Kepit të Rodonit, i cili ndodhet mes gjirit Lalzit dhe Rodonit.

Statuja e Teutës

Qëndron krenare mbi tarracën e Bankës së Shtetit në Durrës dhe prej aty sheh gjithë portin e Durrësit. Figura e saj ka qenë mjaft e rëndësishme për qytetin, pasi ishte një ndër drejtueset e para femër që mbretëroi për tre vjet dhe ndoqi disa strategji që ndikuan drejtpërsëdrejti në fatin e banorëve. Teuta, bashkëshortja e mbretit Ilir, Agron, e mori fronin pas vdekjes së tij dhe vazhdoi të ecte me po të njëjtat hapa kolosale për fuqizimin e shtetit. Si e tillë ajo nuk shihej me sy dashamirës nga fqinjët të cilët synonin të pushtonin Durrësin, pikën lidhëse mes Romës dhe Kotandinopojës, dy qytetërimeve më të zhvilluara të kohës. Por ajo ia doli ta forconte qytetin duke ndjekur sloganin "Prijësit ta konsiderojnë armik gjithë bregdetin".

Busti Hafiz Ali Podgorica

Është kryebashkiaku i parë i qytetit (1912) ndaj dhe bustin e tij e kanë vendosur pranë godinës së Bashkisë. Emri i tij lidhet edhe me botën islame pasi Hafiz është një titull që iu jepet personave që mësojnë përmendësh Kuranin. Patrioti i shquar i cili u brumos me idealet rilindase, dha kontribut të çmuar në Shpalljen e Pavarësisë dhe funksionimit të institucioneve shtetërore të asaj kohe. Kjo u nxit nga shkollimi i tij dhe lidhjeve që kishte me figura të tilla si Ismail Qemali, Jani Vreton, Dom Nikoll Kaçorin, etj. Puna e tij si kadi dhe më pas si myfti, angazhimi në klube patriotike e bëri që të ndërgegjësohej dhe të merrej shumë me përhapjen dhe mësimin e gjuhës shqipe. Falë gjithë kësaj eksperience më 1909 -1912 u zgjodh si kryebashkiak i Durrësit dhe disa ditë para se Ismail Qemali të ngrinte flamurin në Vlorë, Hafiz Ali Podgorica më 26 Nëntor 1912 ngriti flamurin në Durrës.

Busti i Mujo Ulqinakut

Ndodhet pranë kullës veneciane, në fillim të shëtitorës së dashur të durrsakëve "Vollga". Ky monument i dedikohet dëshmorit të parë shqiptar të Luftës së Dytë Botërore, rënë më 7 Prill 1939 në mbrojtje të atdheut kundër pushtimit italian të Shqipërisë. Si një detar i zoti, i cili e njihte që në vegjëli detin ai u vu në krye të detarëve durrsakë për të mbrojtur qytetin nga pushtimi fashist.

Ushtari i panjohur

Statuja e ushtarit të panjohur ndodhet përgjatë shëtitorës së Vollgës, buzë detit. Kjo statujë simbolizon lirinë dhe luftën e popullit shqiptar për lirinë e atdheut.



Busti i Teutës



Baba Sarisalltik



Përkujtimore për 2700 ushtarë të anijes "Lloyd Linz" të marinës Austro - Hungareze

Veshjet Popullore.

#VeshjetPopullore. Gjyshërit e mi gjithmonë i ruajnë dhe trashëgojnë me fanatizëm çdo send të vjetër dhe gjithmonë më kanë ushqyer me dëshirën për të njohur gjithçka që i përket kohës kur ata kanë jetuar. Një ditë të shtunë gjyshja vendosi të më tregonte sendet që ai mbante në një dhomë që gjendej gjithmonë e kyçur. Isha shumë kuresh-tare që e vogël të dija pse ajo qëndronte e mbyllur, por ishte ajo ditë që gjyshja kishte vendosur të më tregonte. Sapo hapet dera dukej sikur po shikoja një dhomë parahistorike. Ajo ishte mahnitese.

-Të solla këtu pasi dua që dhe ti, t'i ruash dhe t'i trashëgosh këto vlera. Vendi ynë ka një kulturë dhe trashëgimi të pafund. Kjo pjesa që ti shikon këtu është vendi ku përgatitet qeleshja. Ajo do rreth një orë që të përgatitet. Në fillim lahet leshi i deles me ujë të nxehtë e sapun, vendosej te ky kallëpi i qeramikes dhe ngjishej tërë kohës për ti dhënë formën. Kurse pjesët e tepërta priteshin me gërshërë dhe në fund ai lahej me ujë të ftohtë. Këto dy qeleshet që janë këtu i kam përgatitur për ty dhe vëllain. Qeleshet janë me forma të ndyshme për krahina të ndyshme. Thuhet që ato që jetojnë në zona malore i kanë qeleshet më me majë.

Pak më poshtë më zënë sytë një arkë të vjetër selvije, brenda së cilës ndodheshin dy kostume popullore shumë të vjetëruar. Njeri ishte kostum burrash e tjetri kostum grash. Jeleku i grave ishte më nafsh i qëndisur me fije ari dhe argjendi, kjo lidhej me krahinën prej nga vinte gjyshja ime, ajo ishte një ishmakë 24 karatëshe. Zakoni e donte që nusja ta përgatiste vetë pajën e saj. Krahina të ndyshme kishin tipare të ndyshme në qëndisje dhe në rast se vajza kishte elementin e shqiponjës të qëndisur atëherë ajo përfaqësonte një nga familjet më të pasura. Ndërsa veshja e dhëndrit ishte e përberë nga shajaku, që përdorej nga burrat edhe në jetën e përditshme. Një karakteristikë tjetër e veshjeve është se ato trashëgoheshin për të lënë mbrapa fatin e mirë.

Në një cep të dhomës ndodhej një tejzgjah që shërbente për të bërë qilimet dhe sipër saj ishte varur në mur një pikturë e vjetër e cila paraqiste disa anije të cilat lundronin të qeta në Adriatik. Dukej që ishte punuar nga një piktor

i talentuar për të cilin familja jonë kishte respekt të veçantë pasi gjyshja ime nuk donte ta prekte askush. Një një sirtar të vogël anash raftit ndhodheshin një sërë fotosh të vogla. Ato tregonin jetën e gjyshit femijërinë dhe shtepinë e tij. Më tregoi se dhomat ishin të ndara dhe se kur vinin njerëz për vizitë gratë rrinin veç e burrat veç. Edhe fëmijët kishin vendin e tyre në një dhomë posaçërisht për ta.

Në njërën nga fotot ishte një xhmadan mjaft i vjetër rreth 100 vjeçar që i përkiste zonës së Ishmit. Nuk mund ta besoja që ajo mund të peshonte 10 kilogramë, mbeta e habitur.

Në fund më dha një kuti të madhe të paketuar. Sapo e mora në dorë e dija që ajo do të kishte një vlerë të veçantë për mua. Hoqa me kujdes fjongon e bardhë dhe hapa kapakun. Ishte një fustan që gjyshja ime kishte përgatitur për mua. Ishte një fustan modern i kaltër si deti, qëndisur me modele të vjetra popullore. Punimi ishte mjaft i veçantë dhe kishte akoma më shumë vlerë për mua.

Duke qënë se në ditët e sotme teknologjia po përparon çdo ditë dhe njerëzit po përshtaten me të, po zbehen këto pjesë të historisë që tregojnë se njerëzit kanë projektuar dhe punuar vetë gjithçka. Mendoj se secili nga ne duhet të përpiqet ti ruaj dhe ti trashëgojë vlera që na japin identitet.



Kepi i Rodonit

Kepi i Rodonit që është një ndër vendet më interesante në Shqipëri. Është kepi më i madh në vendin tonë, një vend me shumë histori. Kalaja e Skënderbeut ndodhet në pjesën verilindore të Kepit të Rodonit, ose siç e quajnë vendasit, Kepi i Muzhit dhe vështron veç thellësisë së detit Adriatik, edhe gjirin e Patokut dhe të Shëngjinit.

Këtu ndodhet dhe Kështjella e Skënderbeut. Kjo kështjellë filloi të ngrihej mbas rrethimit të parë të Krujës në vitin 1450. Përfundimi i saj mendohet të jetë bërë rreth vitit 1452. Muri i kështjellës së Rodonit është ndërtuar nga mjeshtra venecianë. Ai arrinte në një gjatësi prej 400 metrash dhe në kulmet e kështjellës kishte kulla të rrumbullakëta. Si rezultat i veprimtarive erozive të ujërave të detit, një pjesë e mureve janë zhytur nën ujërat e detit Adriatik. Kështjella u ngrit nga Skënderbeu për të pasur dalje në det dhe për të mos qenë në varësinë e Venedikut.

Pranë kështjellës së Kepit të Rodonit ndodheshin edhe katër manastire katolike të cilat kanë ekzistuar në këtë vend të vetmuar përpara se të ndërtohej kështjella. Të tilla manastire kanë qenë ai i Shën Anastasisë, Shën Kollit, Shën Mërisë dhe ai i Shën Ndout. Ky i fundit ishte i vetmi objekt që ekzistonte deri përpara disa vjetësh në gjendje rrënoje. Kisha e Shën Ndout ishte ndërtuar me një muraturë prej gurësh shtufi dhe tullash të lidhura me llaç gëlqereje, ku është përdorur teknika bizantine e kluasonazhit. Kisha e Shën Ndout, sipas specialistëve është ndërtuar në shek. XIV-XV.

Vizitë në Ishëm

Sa nga ju e dinë se ku ndodhet Ishmi?

Nëse nuk e dini dhe jeni kurioz ta mësoni po ju them se është një njësi e vogël në Ultësirën Perëndimore, fare pranë qytetit të Durrësit, të cilën mund ta vizitoni lehtësisht me makinën tuaj ose me një makinë të marrë me qira në një nga agjencitë e shumta turistike që ndodhen në qytet. Agjencitë mund ti kontaktoni përmes rrjeteve sociale dhe web-siteve që ato kanë, në këtë mënyrë shmangni pritje në rradhë dhe mund të zgjidhni cilën makinë (shërbim) të

dëshironi duke qënë në qetësinë e dhomës së hotelit.

Sa larg Durrësit është Ishmi dhe çfarë mund të shoh aty?

Kjo është një ndër pyetjet që bëhet më shpesh nga turistë dhe me të drejtë pasi askush nuk do të humb kohë dhe para për të parë një vend i cili nuk ka se çfarë të të ofrojë.

Si fillim duhet të dini se Ishmi është vetëm 45 minuta me makinë larg qytetit të Durrësit dhe në të gjeni disa atraksione të rëndësishme për qytetin, ndër to përmendim: Bazilika Paleokristiane, Kalja e Ishmit, Varri i piktorit të famshëm Ibrahim Kodra, Plazhin e Shën Pjetrit. Duhet theksuar se këto atraksione vizitohen gjatë rrugës për të shkuar në Ishëm ose duke vazhduar më tej për të vizituar Kepin e Rodonit. Duke marrë parasysh ndalesat dhe atraksionin me të largët, por më shplodhës, Plazhin e Shën Pjetrit kjo vizitë mund të zgjas edhe 3-4 orë.

Përse duhet ti vizitohet pikat e sipërpërmendura?

Shumë e thjeshtë, nëse je në të njëjtën kohë aventurier që dëshiron të zbulosh thesare të fshehura dhe kureshtar për të mësuar më shumë për historinë, atëherë e gjithë çfarë të duhet është një vizitë në Ishëm. Them aventurë pasi rruga për të shkuar atje është pak e vështirë por nëse jeni me miq të mirë nuk do e ndjeni fare largësinë. Ju po ndiqni një itinerar që shumë pak turistë e njohin dhe e dini pse? Sepse ata nuk duan të dalin nga zona e komfortit dhe nuk duan të zbulojnë atë çfarë është në të vërtetë Durrësi dhe Ishimi. Gjithashtu për të njohur më mirë historinë dhe zhvillimin që ka patur qyteti që në lashtësi ju duhet të vini dhe të shihni këto pika, në këtë mënyrë do të prekni nga afër gjurmët e ilirëve, të cilët që asokohe merreshin me ndërtimin e anijeve dhe zhvilloni tregtinë në birgjet e Adriatikut.

Cilin monument do të vizitohet parin dhe çfarë rrugë duhet të ndjek?

Pyetje me vend, si fillim vizitohet Bazilika Paleokristiane e cila ndodhet në fshatin Gjericaj, në lindje të kodrave të Ishmit. Për ta vizituar atë ju duhet të merrni autostradën Tiranë- Durrës, duke kaluar kështu në fshatrat Sukth, Maminas dhe Vorë nga ku do të kthehni majtas dhe do të

vazhdoni për në breg Shozë dhe Bubq, më pas do të kaloni fshatin Mallkuç dhe do të gjeni Bazilikën Paleokristjane në Gjuricaj. (Nëse doni të shmangni hartat dhe udhëzuesit e dorës mund të përdorni google map, një aplikacion shumë i vlefshëm më turistët, në raste se nuk doni ti besoni a google map atëherë mund të kontaktoni agjencitë turistike ose guidat lokale përmes rrjeteve sociale.)

Çfarë përfaqëson Bazilika paleokristiane?

Bazilika paleokristiane është një monument kulture i cili i përket viteve VI-VII të erës sonë dhe tregon shumë për qytetërimin dhe zhvillimin e kësaj zone. Gjatë zbulimit të saj në vitin 1984 janë gjetur objekte arkeologjike të tilla si: monedha, enë, dhe zbulime të ndryshme. Ndërtimi sipas stilit greko-romak tregon për ndikimin që këto dy qytetërime kanë patur në qytetin bregdetar të Durrësit dhe veçanërisht në zonën e Ishmit. Debatit nëse është kishë apo bazilikë, s'humica i është përgjigjur me bazilikë për shkak të përmasës relativisht të vogël dhe formës një konike që ajo ka. Dominimi i popullsisë katolike në këto zona lidhet edhe me shkëmbimet kulturore dhe materiale që popullsia vendase ka patur me venedikasit. Nga gjithë kjo pasuri kulturore shumë pak ka mbetur pasi terreni relativisht i vështirë dhe erozioni i kanë dëmtuar këto monumente.

Çfarë ka mbetur nga Kalaja e Ishmit?

Nga kalaja e Ishmit kanë mbetur gjurmë të cilat tregojnë pozitën e favorshme që ajo ka patur. Sipas të dhënave të mbledhura thuhet se para ndërtimit të kalasë në atë zonë ka qënë një bazë e rëndësishme për ndërtimin e anijeve. Andaj për të frenuar zhvillimin dhe për të mbajtur nën kontroll zonën Perandoria Osmane vendosi të ngrrej një kala të cilin e përfundoi për dy vite (1572-1574). Duhet thënë se kalaja u ngrit në një zonë mjaft të favorshme pasi në të njëjtën kohë mund të shihte e kontrollonte nga 5 kullat e saj edhe Krujën. Jo paqëllim ata vendosën të ndërtoni një kala me lartësi deri në 7 metra dhe me gjerësi deri në 1.5m. Forma e parë e kalasë ka qënë katrore dhe ka patur vetëm dy porta Pavarësisht viteve dhe gjendjes së saj ajo

arrin të tërheq vëmendjen e turistëve kureshtar. Për pak harrova pa thënë faktin se këtu ashtu si edhe në Durrësi, monumentet historike/arkeologjike bashkëjetojnë shumë mirë me të tashmen shpeshherë edhe duke u mbivendosur ose shkrirë me njëra-tjetrën.

A më duhet të eci shumë për të shkuar tek varri i Ibrahim Kodrës?

